



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË
KËSHILLI

Nr. 7275 prot.

Tiranë më 03 / 11 / 2025

VENDIM

Nr. 255, datë 03 . 11 . 2025

**“MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE STANDARDE TË LËVIZJES DHE SIGURISË
NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË ”.**

Bazuar në Ligjin nr. 98 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 27, 28 pika 8, dhe 38, që parashikojnë përkatësisht funksionimin dhe kompetencat e Këshillit të Gjykatës, si dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e shtetit”, VKM nr. 538 datë 08.07.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori”.

KONSTATON

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përbëhet nga dy godina, godina e Dhomës Civile dhe godina e Dhomës Penale ku përfshihen ambientet e brendshme dhe ambientet e jashtme të truallit funksional të gjykatës (parkingu).

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullave standarde të lëvizjes dhe sigurisë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kancelari dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve mbështetëse dhe Prokurimeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Urdhërohet publikimi i kësaj rregullore në faqen zyrtare të gjykatës.
4. Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet Këshillit të Lartë Gjyqësor.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARE
MIGENA LASKA

KRYETARI I KËSHILLIT
GERD HOXHA

ANËTAR
DONALD XHELLI

ANEKS I

RREGULLAT STANDARDE TË LËVIZJES DHE SIGURISË NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde dhe të përbashkëta, lëvizjes dhe sigurisë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 2

Fusha e veprimit

Kjo rregullore zbatohet për gjyqtarët, administratën gjyqësore, palët në proces, personat e thirrur në proces, publikun, si dhe të gjithë përdoruesit e tjerë të gjykatës.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore termit e mëposhtëm kanë këto përkufizime:

- a. **“Gjykata”**, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,
- b. **“Ambient”**, përkatësisht ambientet e brendshme të gjykatës dhe trualli funksional përreth saj, duke përfshirë pjesët e përbashkëta me ndërtesën kryesore, parkingun për automjetet, si dhe çdo objekt tjetër brenda perimetrit rrethues të godinës, që përdoret në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së gjykatës,
- c. **“Kryetar”**, kryetari i gjykatës
- d. **“Kancelar”**, kancelar i gjykatës
- e. **“Palët në proces”**, çdo person fizik dhe përfaqësues i personit juridik, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Palët në proces konsiderohen përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi,
- f. **“Përdorues i gjykatës”**, çdo person fizik ose përfaqësuesi i personit juridik, që nuk është palë në proces, por që dëshmon interes legjitim për akses në ambientet e gjykatës. Përdorues të gjykatës do të konsiderohen përfaqësuesit e institucioneve, delegacionet shtetërore vendndodhje dhe të huaja, donatorët, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e mediave dhe gazetarët e akredituar, monitoruesit e punës së gjykatave, studentët, praktikantët, vizitorët, publiku i përgjithshëm, si dhe palë të tjera që shfaqin interes të ndjekin seancat gjyqësore apo të marrin shërbimet e dhëna nga gjykata,
- g. **“Interesi legjitim”**, nënkupton çdo leje, ftesë, autorizim apo miratim tjetër, i dhënë shprehimisht apo në mënyrë tjetër, me të cilin dëshmohet interesi i palëve të interesuara për akses në ambientet e gjykatave.
- h. **“Punonjës sigurie”** punonjësit e ngarkuar për të garantuar rendin dhe sigurinë në gjykata, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës në fuqi.

- i. **“Hapësire e përbashkët e gjykatës”**, çdo hapësire të kufizuar apo të pakufizuar, në të cilën është e lejueshme akses i përbashkët dhe i pakufizuar, në të cilën është e lejueshme akses i përbashkët dhe i pakufizuar i të gjithë personave. Në kuptim të këtij paragrafi, hapësire e përbashkët e gjykatës do të konsiderohen sallat e gjykimit, zyrat për menaxhimin e çështjeve, hapësirat e përbashkëta të pritjes, hapësirat ku behën shpalljet publike, ashensorët tualetet, korridoret dhe shkallët e gjykatave.
- j. **“Hapësirë e veçantë e gjykatës”**, çdo hapësirë e kufizuar apo e pakufizuar, në të cilën nuk është e lejueshme akses i përbashkët dhe i pakufizuar i të gjithë personave, por kërkon autorizim të veçantë. Në kuptimin e këtij paragrafi, hapësirë e veçantë e gjykatës konsiderohet zyra e kryetarit të gjykatës, zyra e zëvendëskryetarit të gjykatës, zyra e kancelarit, zyrat e gjyqtareve, ambientet e dedikuara për avokatë, dëshmitaret e mbrojtur, personat e ndaluar, të paraburgosur apo të dënuar, arkivi, zyra e punonjësit të sigurisë, dhoma e serverit etj.
- k. **“Person i autorizuar”**, kryetari/kancelari i autorizuar nga kryetari i gjykatës apo çdo person tjetër i autorizuar prej tyre, në mbështetje të nenit 5, pika 1, të kësaj rregulloreje.
- l. **Koordinatori i sigurisë**, nëpunësi përgjegjës për sigurinë në gjykatë.

Neni 4

Akresi dhe shfrytëzimi i hapësirave të përbashkëta në ambientet e gjykatave

1. Hapësirat e përbashkëta në ambientet e gjykatës duhet të shfrytëzohen vetëm për aktivitetet dhe qëllimet për të cilat janë krijuar.
2. Të gjithë përdoruesit e gjykatës kanë akses të pakufizuar dhe gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta në ambientet e gjykatës, përveç kur ajo është e ndaluar shprehimisht dhe për arsye të bazuara, ose në bazë të një vendimi, urdhri apo sinjalistike të caktuar.

Neni 5

Akresi dhe shfrytëzimi i hapësirave të veçanta të ambienteve të gjykatës

1. Akresi dhe shfrytëzimi i hapësirave të veçanta të ambienteve të gjykatës është i kufizuar dhe lejohet vetëm në kushte të caktuara me akte ligjore apo nënligjore, ose me miratimin apo autorizimin paraprak të personit të autorizuar.
2. Çdo akses dhe shfrytëzim i hapësirave të veçanta të ambienteve të gjykatës duhet të regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e personit që realizon vizitën, datën, orën dhe zyrën në të cilën është lejuar vizita.

Neni 6

Koha dhe hyrja në ambientet e gjykatës

1. Hyrja në ambientet e gjykatës do të bëhet gjatë orarit zyrtar të punës 08:00 - 16:00, të shpallur publikisht dhe të vendosur në një vend të dukshëm.
2. Administrata gjyqësore është e detyruar të mbajë dokument identifikues gjatë orarit zyrtar të punës. Gjykata do të prodhojë dhe lëshojë në përdorim dokument identifikues

për gjyqtarët, administratën e gjykatës, palët në proces, palët e interesuara, vizitorë.

3. Përdoruesit e gjykatës lejohet të kenë akses në të gjitha hapësirat e përbashkëta të gjykatës. Për akses në hapësirat e veçanta, përdoruesit duhet të dëshmojnë një interes legjitim. Përdoruesit duhet të identifikohen përmes një dokumenti të vlefshëm identifikimi.
4. Gjykata duhet të sigurojë akses të lehtë në sallën e gjykimit për persona me aftësi ndryshe.
5. Të miturit duhet të kenë akses në gjykatë kur është e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Përdorimi i shkallëve të emergjencës në gjykatë lejohet vetëm për rastet emergjente, të cilat përcaktohen sipas protokolleve të sigurisë.
7. Aksesit në gjykatë për vizitorët dhe palët në proces nuk lejohet në rast se këta të fundit kanë veshje jo-etike sipas përcaktime në rregulloren e gjykatës dhe të afishuara në vende të dukshme për publikun
8. Hyrja në ambientet e gjykatës do të përcaktohet nga Këshilli i Gjykatës, i cili miraton rregulla të veçanta për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë, në zbatim të nenit 38, shkronja 'g', të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7

Sigurimi i ambienteve

1. Ndërtesa e gjykatës ruhet me punonjës të sigurisë, për të garantuar ruajtjen e rregullit e të sigurisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Rregullat e regjistrimit të hyrjeve dhe identifikimin e personave parashikohen në nenin 11 të kësaj rregullore.
3. Hyrja në godinë:
 - a. hyrja e publikut në godinën e gjykatës realizohet vetëm nëpërmjet hyrjes kryesore, pas verifikimit fizik nëpërmjet pajisjeve të teknologjisë (skanet, dedektor etj..) dhe dokumentit të identifikimit nga punonjësi i sigurisë, i cili shënohet në regjistrin përkatës nga punonjësi i sigurisë;
 - b. hyrja kryesore e godinës së gjykatës mbikëqyret nga një ose disa punonjës të sigurisë;
 - c. çdo person i nënshtrohet procedurave të kontrollit dhe të sigurisë në momentin e hyrjes në godinë;
 - d. magjistratët, punonjësit e administratës së gjykatës, si dhe personat e autorizuar nga kryetari hyjnë në godinë nëpërmjet një hyrjeje të veçantë, në bazë të dokumentit të identifikimit;
 - e. hyrja e personave të ndaluar apo të arrestuar, të paraburgosurve dhe të dënuarve të shoqëruar realizohet nëpërmjet hyrjes së veçantë për këto kategori;
 - f. përfaqësuesit e policisë së shtetit dhe të sigurisë lejohet të hyjnë në ambientet e gjykatave gjatë orarit zyrtar të punës, kur kjo është e arsyeshme dhe e domosdoshme;

- g. hyrjet e veçanta, sipas shkronjave "d" dhe "e", të këtij neni, shërbejnë edhe si dalje emergjence në rastet kur jepet urdhër për evakuim nga kryetari;
4. Hyrja e automjeteve:
- hyrja e automjeteve në dispozicion të gjykatës, të automjeteve private të magistratëve dhe të punonjësve të administratës, e mjeteve të cilat transportojnë të akuzuarit nga institucionet e paraburgimit dhe të dënuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit, për të marrë pjesë në seancë, si dhe të automjeteve të furnizimit dhe ofruesve të jashtëm të shërbimit, realizohet përmes portave të veçanta për hyrjen e këtyre automjeteve;
 - në raste të veçanta, sipas rastit, mund të lejohen të hyjnë edhe automjete të tjera, vetëm me autorizim paraprak të kryetarit;
 - hapësira e parkimit rreth godinës së gjykatës përdoret vetëm për automjetet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 3 të këtij neni;
 - hyrja e automjeteve mbikëqyret me punonjës sigurie/punonjës policie.
5. Siguria në godinë:
- Rregullat bazë të sigurisë që duhet të përmbushen nga gjykata janë :
 - pajisja me detektorë elektronikë, që vendosen pranë hyrjes kryesore për diktimin e hyrjeve të paautorizuara;
 - vendosja e pajisjeve të testuara për fikjen e zjarrit në ambientet e godinës gjykatës, si dhe sistemit të alarmit të zjarrit;
 - pajisja me mjete të sigurisë (çelësa, karta hyrjeje apo mjete të tjera të kësaj natyre) e punonjësve të administratës të gjykatës, me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së institucionit ;
 - pajisja me sistemin e kamerave të vëzhgimit të lidhura me detektorë alarmi dhe atë elektronik të lejimit të hyrjes në godinë, si dhe me server të ruajtjes së këtyre të dhënave për një periudhë deri në 2 muaj;
 - pajisja e dritareve të veçanta që paraqesin rrezik me sistem elektronik detektimi, me sensorë apo detektorë;
 - vendosja e sinjalistikës për vendkalimet e emergjencës që i mundësojnë personelit dhe publikut të dalë jashtë me shpejtësi;
 - informacioni i përmbledhur mbi rregullat bazë të sigurisë afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të gjykatës;
 - gjykata përcakton personat përgjegjës që do të kenë akses në sistemet e kamerave, si dhe vendosin rregulla specifike lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me udhëzimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 8

Punonjësi i sigurisë

1. Punonjësi i sigurisë garanton rregullin dhe sigurinë, në:
 - a. hyrjet kryesore dhe të veçanta të institucionit përkatës;
 - b. portat për hyrjen e automjeteve dhe hapësirën e parkimit;
 - c. sallën e gjyqit, nëse i kërkohet nga kryetari i seancës, në zbatim të urdhrave të dhënë prej tij;
 - d. ambientet e tjera të brendshme, të cilat përfshijnë kryesisht korridoret lidhëse pranë zyrave, si dhe brenda perimetrit rrethues të godinës së institucionit.
2. Punonjësi i sigurisë ka uniformën e tij të veçantë, me qëllim evidentimin nga publiku, si dhe pajiset me mjet identifikimi, që përmban në mënyrë të dallueshme fotografinë e punonjësit, funksionin e tij dhe shenjën dalluese të subjektit të ofrimit të shërbimit të sigurisë.
3. Punonjësi i sigurisë është i detyruar të mbaje në vend të dukshëm mjetin e identifikimit, gjatë gjithë qëndrimit të tij në ambientet e gjykatës.
4. Punonjësi i sigurisë mund të kontrollojë hyrjen e godinës apo automjetet dhe personat që dyshohen se përbejnë rrezik për sigurinë e mjediseve, brenda një perimetri prej 5 metrash rreth godinës së institucionit të gjykatës, duke nisur prej vijës së objektit.
- 5.

Neni 9

Zbatimi i kontroleve të sigurisë dhe artikujt e ndaluar

1. Në momentin e hyrjes në ambientet e gjykatës, të gjithë personat duhet t'i nënshtrohen kontroleve të sigurisë, me qëllim parandalimin e futjes së artikujve apo objekteve të paautorizuara.
2. Kontrollat e sigurisë zbatohen nga punonjësi i sigurisë në gjykatë. Kontrolli duhet të jetë i arsyeshëm dhe të zbatohet në atë mënyrë që të mos çënohet dinjiteti njerëzor.
3. Procedura e verifikimit dhe e kontrollit të personave nga punonjësi i sigurisë konsiston dhe kryhet, si me poshtë vijon:
 - a. kontrolli i identitetit të personave që hyjnë ose qëndrojnë në ambientet e institucionit, nëpërmjet verifikimit të dokumentit të identifikimit të këtyre personave;
 - b. në rast se personi që hyn nuk posedon asnjë dokument identifikimi, identifikimi i tij mund të konfirmohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme;
 - c. në rast se identiteti i personit nuk mund të konfirmohet, punonjësi i sigurisë nuk lejon hyrjen e tij në institucionin përkatës;
 - d. kontrolli fizik i personave që hyjnë, qëndrojnë ose largohen nga ambientet e institucionit përkatës, si dhe i sendeve që zotërojnë apo mbajnë me vete;
 - e. kontrolli sipas shkronjës "d", të pikës 3, të këtij neni, mund të behet nëpërmjet këqyrjes, prekjës sipërfaqësore ose duke përdorur mjete të tjera të përshtatshme, të tilla si detektorët;

- f. kontrolli që përfshin prekjen sipërfaqësore bëhet nga punonjësi i sigurisë me gjininë e njëjtë me personin që hyn, qëndron ose largohet nga ambientet e institucionit, përveçse në rastet kur nuk është e mundur kryerja e kontrollit aty për aty, në mënyre të menjëhershme.
4. Regjistrimi i sendeve bëhet, si më poshtë vijon:
 - a. punonjësi i sigurisë ruan përkohësisht sende të personit, në vende të krijuara posaçërisht për këtë qëllim, për të lejuar personin të hyjë në ambientet e institucionit;
 - b. regjistrimi i sendeve të mbajtura bëhet në forme të shkruar dhe me nënshkrimin e personit që posedon këtë send;
 - c. personi, i cili kundërshton mbajtjen e sendit/eve të ndaluar/a, nuk lejohet të hyjë në institucion;
 - d. punonjësi i sigurisë mban përgjegjësi për ruajtjen e sendit gjatë kohës që personi qëndron në ambientet e gjykatës.
5. Refuzimi për t'iu nënshtruar kontrolleve të sigurisë përbën bazë të mjaftueshme për ndalimin e aksesit në ambientet e gjykatës dhe largimin e tyre nga objekti.
6. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në ambientet e gjykatës nuk lejohet mbajtja e sendeve, por pa u kufizuar vetëm në to, të përcaktuara, si më poshtë:
 - a. Armët, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për armët;
 - b. Sende të mprehta ose me majë (duke përfshirë brisqe, gërshtë, kaçavida, shufra metalike ose çdo send tjetër të ngjashëm);
 - c. Eksplozive dhe mjete piroteknike;
 - d. Materiale radioaktive dhe helme;
 - e. Spray për mbrojtje;
 - f. Substanca kimike, materiale apo gazra të tjera të ndezshme;
 - g. Substanca narkotike e psikotrope dhe prekursorët e tyre;
 - h. Pije alkoolike të të gjitha llojeve;
 - i. Kafshë të të gjitha llojeve;
 - j. Çdo mjet tjetër që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe rregullin ambientet e gjykatës.
7. Lista e sendeve të ndaluara, sipas pikës 6, të këtij neni, afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse gjykatës.
8. Përjashtimisht, kontrollet e sigurisë nuk do të zbatohen ndaj përfaqësuesve të policisë së shtetit, të sigurisë dhe zyrtarë dhe funksionarë të cilët janë në ushtrim të detyrës zyrtare dhe që sipas ligjit apo rregullave janë të autorizuar të jenë të pajisur me armë zjarri.
9. Përfaqësuesit e policisë, të ushtrisë, të agjensive të tjera ligjzbatuese apo të institucioneve të tjera të sigurisë publike apo private, janë të ftuar si palë në procedurë gjyqësore dhe jo si përfaqësues i këtyre organeve, u ndalohej hyrja me uniformë dhe mbajtja e armëve (të zjarrit, armë të ftohta, spraj, pranga, shkop gome etj..).
10. Rregullat për sendet e ndaluara nuk zbatohen për:
 - a. personat, që mbajnë armë vetëm për shkak të funksionit dhe gjatë kryerjes së tij;
 - b. sende që përbejnë provë materiale, për qëllime të gjyqësorit.

Neni 10
Detyrat e punonjësit të sigurisë

- I. Punonjësi i sigurisë, me qëllim ruajtjen e rregullit të sigurisë në gjykatë, kryen detyrat e mëposhtme:
 - a. siguron ndalimin e hyrjes për personat, të cilët paraqesin rrezik për sigurinë e personave ose të godinës së gjykatës;
 - b. kur mbajtja me vete e sendeve të ndaluara përben vepër penale, punonjësi i sigurisë autorizohet të ndalojë mbajtësin e tyre dhe të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - c. ushtron kontroll personal nëpërmjet pajisjeve teknike dhe inspekton çantat e personave që hyjnë në ambientet e brendshme të gjykatës;
 - d. merr masa për bllokimin e përkohshëm të sendeve, mbajtja dhe futja në institucion e të cilave është e ndaluar sipas kësaj rregulloreje, me qëllim për të lejuar personin të hyjë në ambientet e gjykatës;
 - e. informon kryetarin e gjykatës dhe, në mungesë të tij, kancelarin, për sjellje të dyshimta nga personat që ndodhen në ambientet e godinës së gjykatës;
 - f. merr masat e nevojshme për kufizimin e qarkullimit të automjeteve të palejuara në hapësirat e parkimit, në garazhe, si dhe në oborrin e gjykatës;
 - g. përdor forcën fizike në përpruthje dhe proporcion me rastet që e kanë diktuar atë dhe aq sa është e nevojshme për të shmangur apo neutralizuar situatën e rrezikut të krijuar;
 - h. raporton pranë kryetarit dhe kancelarit të gjykatës përkatëse, telefonatat që përmbajnë kërcënime të shprehura apo nënkuptojnë mundësinë e një rreziku real për magjistratët dhe/apo punonjësit e administratës;
 - i. orienton palët, në zbatim të urdhrave të kryetarit dhe kancelarit sipas autorizimit të kryetarit të gjykatës;
 - j. mban kontakte të vazhdueshme me institucione si policia, personeli i grupit të shoqërimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, spitalet, zjarrfikëset dhe i raporton në mënyre periodike kryetarit dhe kancelarit të gjykatës;
 - k. ndërmer kontrollë rutinë për të gjitha pajisjet e sigurisë dhe i raporton me shkrim kryetarit dhe kancelarit të gjykatës në rast të mosfunksionimit të këtyre pajisjeve;
 - l. vlerëson mjediset e prirura ndaj zjarrit dhe mbron personat, si dhe pasuritë nga rreziku i ndezjes apo shpërthimit të zjarrit;
 - m. kryen evakuimin e godinës, në zbatim të urdhrit verbal të kryetarit dhe kancelarit, sipas planeve të emergjencave të përcaktuara për rastet e evakuimit. Në rastet e rrezikut të madh e të menjëhershëm, evakuimi mund të kryhet edhe pa urdhër, sipas protokollit.
 - n. informon menjëherë kryetarin dhe kancelarin, si dhe strukturat policore për çdo ngjarje të rëndë që paraqet rrezik real dhe cënon sigurinë e gjykatës, e cila konstatohet

edhe pas orarit zyrtar.

Neni 11

Regjistrimi i hyrjeve dhe identifikimi i personave

1. Përveç gjyqtarëve, administratës gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të gjykatës, të gjithë personat që hyjnë në ambientet e gjykatës dhe kërkojnë akses në hapësirat e veçanta, duhet fillimisht të regjistrohen në regjistrat e hyrjes të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregullore. Gjykata është e detyruar të mbajë regjistra, qofte fizikë apo elektronikë (softëare), në të cilat bëhet regjistrimi i hyrjeve.
2. Në hyrjen e ambientit të gjykatës, të gjithë personat duhet të identifikohen personalisht përmes dokumentit që dëshmon identitetin. Palët në proces, palët e interesuara dhe vizitorët do të pajisen me dokument (kartela) identifikuese, që mbajnë mbishkrimin "*Palë në procedurë gjyqësore*" dhe "*Vizitor*", respektivisht.
3. Dokumentet (kartelat) identifikuese duhet të jenë të vendosura në një vend lehtësisht të dukshëm dhe duhet të mbahen gjatë gjithë kohës së qëndrimit në ambientet e gjykatës.

Neni 12

Drejtimi i personelit të sigurisë

1. Shefi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve drejton dhe mbikqyr veprimtarinë e koordinorit të sigurisë dhe punonjësit e sigurisë, e cila kryhet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje.
2. Këtë veprimtari e raportojnë periodikisht tek kryetari dhe kancelari.
3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, shefi i sektorit në bashkëpunim me koordinatorin e sigurisë kryen këto detyra:
 - a. merr masat për mbajtjen e pajisjeve teknike në gjendje funksionale dhe testimin sistematik të tyre;
 - b. merr masat e nevojshme për furnizimin me energji elektrike në mënyre të qëndrueshme dhe vendosjen e gjeneratorëve në vende të sigurt;
 - c. merr masat për sigurimin e mirëmbajtjes dhe të kontrollit të rregullt të sistemeve të informacionit;
 - d. merr çdo masë tjetër të nevojshme për të garantuar rregullin dhe sigurinë në ambientet e gjykatës.

Neni 13

Detyrat e Kryetarit dhe Kancelarit në raport me sigurinë në gjykatë

1. Në ushtrimin e funksioneve të tij, kryetari dhe kancelari me autorizim nga kryetari kryen këto detyra:
 - a. jep urdhra verbale për evakuim;

- në rast rreziku brenda godinës, që nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër;
 - në rast aktivizimi të sistemit të alarmit për rënien e zjarrit.
- b. mban kontakte të herëpashershme me strukturat drejtuese policore, për të garantuar rregullin dhe sigurinë;
 - c. harton planet e veprimit për sigurimin e rregullit në institucion;
 - d. krijon dhe përditëson një regjistër të sigurisë ndaj zjarrit, i cili përmban të gjitha informacionet e domosdoshme për sigurinë nga zjarri për ndërtesat e hapura për publikun dhe shërben si regjistër sigurie dhe si historik i parandalimit dhe fikjes së zjarreve.
2. Gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, me qëllim garantimin e rregullit e të sigurisë, kryetari ndihmohet nga kancelari, shefi i sektorit dhe koordinatori i sigurisë për përmbushjen e tyre.

Neni 14

Kujdesi ndaj aktiveve

1. Administrata gjyqësore para kryerjes së orarit dhe para daljes nga zyra duhet të sigurohet për sigurinë e aktiveve duke filluar nga mbyllja e dritareve, gjendjen e materialeve në zyrë. heqja nga priza e mjeteve për ngrohje, fikja e dritave, mbyllja e derës etj.
2. Në rastet kur nëpunësit/punonjësit i lind dyshimi se diçka nuk është në rregull me mjetet elektrike apo diçka e ngjashme, ai paraprakisht duhet të njoftojë punonjësin e sigurimit, apo personin lidhur me sigurinë në gjykatë.
3. Pas kryerjes së orarit të rregullt të punës, punonjësi i sigurimit në gjykatë, ka për detyrë të vërtetojë gjendjen e përgjithshme të ambientit të gjykatës. Kjo përfshin kontrollin në secilin kat, duke u siguruar se nuk ekziston asgjë e jashtëzakonshme.

Neni 15

Lëvizja e aktiveve të gjykatës

Aktivet e gjykatës lejohet të futet brenda gjykatës apo të largohet nga gjykata vetëm me autorizim të kryetarit të gjykatës ose personit përgjegjës. Lëvizja e aktiveve duhet të bëhet gjatë orarit zyrtar të punës, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 16

Shpalljet publike në ambientet e gjykatave

1. Të gjitha shpalljet publike të gjykatës duhet të behën në hapësirat e përcaktuara për këtë qëllim.
2. Të gjitha ambientet e gjykatës duhet të kenë hapësirën e dedikuar për shpallje publike, e cila duhet të jetë në formë fizike ose më ane të monitorëve elektronikë dhe duhet të jetë

e dukshme dhe lehtësisht e aksesueshme për publikun.

3. Njoftimi për zhvillimin e seancave gjyqësore do të shpallet jo më vonë se 48 orë përpara kohës së caktuar për zhvillimin e seancave.
4. Kancelari i gjykatës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përditësimin e rregullt të shpalljeve publike.

Neni 17

Përgjegjësia për zbatim dhe sanksionet

1. Këshilli i gjykatës miraton rregulla të veçanta për çështje të ruajtjes dhe të sigurisë në gjykatë.
2. Në raste urgjence dhe në raste të cenimit të sigurisë në gjykatë, Kryetari i gjykatës dhe Kancelari me autorizim nga Kryetari i Gjykatës merr masat për zbatimin e rregullave për ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në gjykatë.
3. Në rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, gjetjes së armëve gjatë kontrollit, kundërshtimit të urdhrave me shkrim dhe gojë, punonjësi i sigurimit do të përdorë masat e nevojshme dhe të përshtatshme ligjore, sipas protokollit të sigurisë.
4. Shkelja e dispozitave për ruajtjen dhe sigurinë në gjykatë, nga ana e administratës gjyqësore përben shkak për përgjegjësi disiplinore, ndërsa për publikun largimin nga objekti dhe në raste të caktuara raportimin e rastit në Policinë e Shtetit.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.